



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë, 26/07/2018

**Shpallja e propozimeve fituese mbi përzgjedhjen e Rregulluesit Kryesor**

Më 22 qershor 2018, është publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesa për propozime ("RfP") në kontekstin e emetimit të Eurobondit dhe të ri-blerjes së detyrimeve ekzistuese të Shqipërisë në lidhje me përzgjedhjen e rregulluesit kryesor.

Nga data 10 Korrik-26 Korrik 2018, Komisioni Përzgjedhës i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shqyrtoi të gjitha propozimet me shkrim të marra në kontekstin e Kërkesës për Propozime.

Sipas VKM Nr. 253, Datë 09.05.2018, përzgjedhja e Rregulluesëve Kryesorë (Joint Lead Managers) është kryer bazuar në kriteret e mëposhtme:

- 1) Përvoja në transaksione të ngjashme, përvoja në treg dhe kapaciteti për të siguruar fondet e kërkuara: Komisioni i Përzgjedhjes i kushtoi vëmendje përvojës së ekipit të propozuar, kredencialeve të bankave në transaksione të ngjashme me fokus në rajonin e Europës Qendrore dhe Lindore, në aftësitë tregtare të bankës si dhe në angazhimin e saj ndaj vendit.
- 2) Risqet e ndryshme të secilit propozim: Komisioni i Përzgjedhjes vlerësoi, ndër të tjera, përshkrimin e dinamikës bazë të tregjeve të obligacioneve të tregjeve në zhvillim, cilësinë e rekomandimeve në lidhje me emetimin e obligacioneve të parashikuara dhe menaxhimin e detyrimeve, rekomandimet në lidhje me strategjinë e marketingut.
- 3) Komisionet, interesat dhe çdo faktor tjetër që mund të ndikojë në koston e përgjithshme.

Bazuar në këto kriteret, Ministria e Financave dhe Ekonomisë njofton se ka përzgjedhur Citi, Banca IMI dhe Societe Generale të veprojnë si Rregullues Kryesorë të përbashkët (Joint Lead Managers) të Transaksionit.